

SHENIMET SHPJEGUESE

Subjekti Fin Pek Petroleum Sh.a, Fier ,me NIPT L01410008B hartoi pasqyrat financiare kontabel per periudhen 01.01.2021 deri 31.12.2021 ne mbeshtetje te ligjit Nr. 9228 date 29.04.2004 " Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe pasqyrimin e tyre sipas SKK 2, paragrafeve 49-55.

Parimet kryesore te cilat janë mbajtur parasysh në hartimin e pasqyrave janë

1.Parimi i te drejtave të Konstatuara ,pra rregjistrimet janë vleresuar me cmimin kur kane ndodhur dhe jo kur jane paguar apo arketuar.

2.Parimi i vijimesise së llogarive kontabel.

Subjekti ka realizuar hartimin e pasqyrave financiare duke zbatuar politikat kontabel per aspekte si vijon:

Shpjegimet ne Aktive te Pasqyrave:

1. Aktivet monetare jane kontabilizuar sipas llogarive analitike kontabel, te Bankes dhe Arkes. Vlera e paraqitur ne keto zëra është sasia e parave që ka subjekti me 31.12.2021 gjendje ne Arke dhe ne Banke, pervec transaksioneve normale me kreditore dhe debitor te shoqeris perben rasti i mbylljes me merveshje per shuarjen e detyrimeve mes Fin Pek Petroleum, Eda C&S Shpk si furnitor dhe RBH Beline Sh.a si debitor per shitje mallrash, vlera per mbylljen e dhe shuarjen e detyrimeve mes paleve eshte 27.708.486 leke.

2. Klientet e subjektit ne daten 31.12.2019 jane ne vleren 686.608 leke.

3.Tatimi mbi fitimin paraqitet negativ sipas bilancit me 31.12.2021 ne shumen 1.481.527 lekë, krahasuar me periudhen parardhese rezulton se kemi nje rezultat financiar pozitiv, per faktin se Shoqeria Fin Pek Petroleum Sh.a, me 23.05.2016 ka nenshkruar nje Marreveshje Shfrytezim Prodhim Hidrokarbure, e cila eshte bere efektive me 01.06.2016, nga e cila ka rezultuar nje prodhim, produkt i gatshem ne vleren -555.042 leke, i cili ka ndikuar ne uljen e rezultatit , nisur nga ky fakt parashikojme qe ne periudhen ushtrimore ne vazhdim, shoqeria te kopesoje humbjet e periudhave paraardhese, dhe te dale me fitim, shoqeria per kete periudhe nuk dele me fitim te pagueshem pasi ne deklarate do te kompesoje humbjet e periudhave te meparshme.

3. Inventari material i produktit te gatshem (Nafte Bruto) eshte kontabilizuar duke zbatuar metoden e vleresimit me me te voglen mes kosos dhe çmimit te tregut, ne fund te periudhes kontabel, referuar Burse Brent (Dtd) publikuar ne buletin e Agjensise Prokurimeve Publike me daten e fundit muajit perkates, dhe vlera totale e inventarit ne fund te periudhes ushtrimore eshte 9.213.605 leke, ne kete vlere eshte perfshire dhe produkti i gatshem Nafte Bruto ne formen e PPE & ASP per Albpetrol Sh.a si detyrim i Marreveshjes Hidrokarbure, qe shoqeria ka nenshkruar me Albpetrol Sh.a .

4. Vleresimi i Aktiveve Materiale afatgjata te hyra gjate periudhes ushtrimore eshte trajtuar ne kontabilitet sipas formes se marrjes me konçension te tyre, ku jane çelur llogarite korresponduese si ne debi dhe ne kredi, keto aktive jane vlersuar me çmim per cope sipas inventareve te Konçensiondhensit.

Shpjegimet ne Pasive dhe Kapitale te Pasqyrave:

1. Gjendja e llogarise "detyrime per sig shoq "paraqet detyrimin që ka subjekti ndaj shtetit per per sig shoqerore. Kjo llogari eshte e perputhur me raportimet dhe gjendjen e formulareve ne daten 31.12.2021)

1. Gjendja e llogarise "furnitor "eshte e rakorduar me furnitoret sipas listes bashkangjitur.Ne llogarite e detyrimeve per Shtetin (Tvsh, Tatim Fitimin ,Sigurime ,TAP) paraqiten raportimet e llogarive perkatese dhe duke u mbeshtetur mbi gjendjen e formulareve ne daten 31.12.2020).

Te dhenat shifrore si ne aktiv dhe ne pasiv te pasqyrave financiare jane rezultat i zbatimit te parimeve ' Te rregjistrimit te ngjarjeve ne momentin e konstatimit e perputhur me kohen kur ka ndodhur ngjarja ekonomike.

Shpjegimet ne Pasqyren e të Ardhurave dhe Shpenzimeve:

Në shitjet neto paraqitet shuma totale e llogarisë ,705 e cila është shitje mallrash.

Ne llogarinë materialet e konsumuara paraqiten shërbimet dhe mallrat e perdorura gjate aktivitetit për vitin 2021 të përlllogaritura me koston e blerjes,(hyrjes ne magazine)

Ne zërin kosto e punes paraqiten shpenzime pagash dhe shpenzimet per sigurimet shoqërore të cilat janë përlllogaritur sipas pasqyrave të pagave dhe sig shoqerore.

Në zërin shpenzime të tjera janë përmbledhur të gjitha shpenzimet per komisione bankare,per qerane dhe shpenzime telefoni. Në zërin të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat paraqiten interesa bankare të llogaritura sipas postes bankare. Në zërin fitimi dhe humbja para tatimit në shumën 9.876.849 lekë paraqitet humbja e ushtrimit.

Shpjegimet ne Pasqyren e fluksit monetar.

Në hartimin e pasqyrave financiare, pasqyra e fluksit të parave është paraqitur sipas metodës direkte.

Shkurtimisht në këtë pasqyre janë paraqitur:

Mjetet monetare të arketuar nga klientet në shumën 44.146.382 lekë. Në mjetet monetare të paguara ndaj furnitoreve dhe punonjesve paraqiten shumat e pagura per furnitoret per blerjen e mallrave, shumat e paguara per pagat dhe sig shoqërore.

Në zërin te tjera paraqiten pagesat ne banke per komisionet bankare, veprime te tjera te pa raportuara ne Bilanc nuk ka.

ADMINISTRATORI

